

TERMAT E REFERENCËS

PËRPILIMI I STRATEGJISË PËR NGRITJE TË FONDEVE

1. PROFILI I CARITAS KOSOVA

Caritas Kosova (CK) si institucion i bamirësisë promovon drejtësinë, vlerat universale dhe ndërtimin e paqes, përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve, gjithëpërfshirjen sociale, jep shpresë për të pambrojturit dhe kujdeset që të rimëkëmben grupet në nevojë duke i fuqizuar ata në realizimin e të drejtave themelore në të gjitha fushat e zhvillimit njerëzor.

Fushat strategjike në të cilat Caritas Kosova aktualisht është përqendruar janë:

- *Përkujdesi shëndetësor dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore;*
- *Përmirësimi i pozitës sociale të njerëzve në nevojë dhe zhvillimi i komunitetit për përfshirje dhe kohezion social;*
- *Krijimi i parakushteve për rritjen e punësueshmërisë dhe të vetëpunësimit;*
- *Realizimi i së drejtës në edukim dhe arsim cilësor;*
- *Ndihma në situatat e fatkeqësive natyrore dhe të konflikteve.*

Të dhëna rreth Organizatës:

- Numri i Certifikatës së Regjistrimit: **5200022-0**
- Numri i Përfituesit Publik: **6000489-9**
- Numri i TVSH-së: **330242206**
- Numri Fiskal: **600246765**
- Nr. i punonjësve në vitin 2022: **500**
- Nr. i Sektorëve **6**
- Nr. i Zyrave Regionale **5**

Caritas Kosova fton Ekspertët/Kompanitë që ofrojnë shërbime të konsulecës që të shprehin interesimin e tyre përmes ofertës për Përpilimin e Strategjisë për ngritje të fondeve në: alfred.pjetri@caritaskosova.org, deri më **13.10.2022** në ora **16:00**.

2. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj konsulence është angazhimi i një Eksperti/Kompanie konsulente i cili do të punojë ngusht me stafin e CK në analizën dhe hartimin e Strategjisë për ngritje të fondeve, duke u bazuar në përvojën dhe praktikat aktuale të organizatës si dhe në hulumtimin dhe adaptimin e strategjive të suksesshme duke marrur për bazë autenticitetin, identitetin dhe natyrën e organizatës.

3. OBJEKTIVAT DHE FUSHËVËPRIMET

Eksperti/Kompania konsulente e angazhuar, do të hartojë planin e aktiviteteve i cili do të aprovohet nga CK, zhvilloj takimet me stafin, do të analizojë dokumentet, politikat, procedurat ekzistuese të CK dhe do të hartojë Strategjinë për ngritjen e fondeve që do ti përgjigjet nevojave dhe mundësive për diversifikim të fondeve të cilat janë të nevojshme për vazhdimin e shërbimeve dhe mbështetjes që Caritas Kosova ofron për kategori të ndryshme në nevojë.

Ky dokument duhet ti përgjigjet nevojave, kompleksitetit dhe madhësisë së Caritas Kosova dhe të jetë në linjë me kornizën ligjore në Kosovë, praktikat ndërkombëtare (sidomos ato brenda rrjetit Caritas) si dhe detyrimet që dalin nga CIMS (Caritas Internationalis Management Standards).

Përgjegjësitë e Ekspertit/Kompanisë konsulente për Hartimin e Strategjisë për ngritjen e fondeve janë:

- Të diskutoj me Menaxhmentin e CK në lidhje me idetë, mundësitë, dhe nevojat e organizatës për strategjinë në fjalë
- Të vlerësoj kontekstin, kapacitetin dhe perspektivat afatgjata të organizatës për qëllimet dhe veprimet strategjike për ngritjen e fondeve me fokus në sektorin publik, privat, të shoqërisë civile, etj.
- Piketoj dhe identifikoj sektorë, kanale por edhe subjekte potenciale për ngritjen e fondeve si dhe trendet e tyre
- Përcaktoj planin për ngritje të fondeve, objektivat strategjike, prioritetet, buxhetin, monitorimin dhe vlerësimin
- Të analizoj dhe pasqyroj në Strategjinë për ngritjen e fondeve të gjitha obligimet që dalin nga Kodi i Etikës & Kodi ti Sjelljes për Stafin, CIMS dhe Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rriturve të Cënuar
- Të përpiloj Strategjinë për ngritjen e fondeve
- Të asistoj CK në trajnimin e stafit për zbatimin e Strategjisë

4. KOHËZGJATJA

Eksperti/Kompania e zgjedhur do të kontraktohet nga CK dhe do të zhvilloj aktivitetet e nevojshme për hartimin e Strategjisë për ngritjen e fondeve. Puna rreth strategjisë do të kryhet në periudhë prej 3 muaj nga data e nënshkrimi të kontratës.

5. MARRËDHËNIET E PUNËS DHE MARRËVESHJET KONTRAKTUALE

- Eksperti/Kompania konsulente do të punoj në bashkëpunim të ngushtë dhe mbikëqyrje të Drejtorit Ekzekutiv të CK
- Eksperti/Kompania konsulente duhet të trajtoj me konfidencialitet të gjitha informacionet e CK që shpërndahen gjatë këtij procesi

6. TË DHËNAT, PERSONELI DHE HAPËSIRAT E PUNËS

Ekspertit/Kompanisë konsulente do t'i jepet qasje në të gjitha dokumentet relevante që ndërlidhen me çështjen e burimeve njerëzore. Menaxhmenti dhe Stafi i CK do të ofroj informata dhe orientim në lidhje me pritjet dhe rezultatet e kërkuara për Manualin e Burimeve Njerëzore.

Të dhënat

- Gjuha themelore e të gjithë dokumentacionit është gjuha angleze dhe gjuha shqipe.
- Të gjitha dokumentet që merren 'hard copy' do të kthehen në fund të procesit
- Strategjia për ngritjen e fondeve është dokumenti final i prodhuar dhe dorëzohet në gjuhën shqipe dhe angleze

Personeli

- Eksperti/Kompania konsulente është përgjegjëse për caktimin e Personit përgjegjës që do të udheheqë këtë proces dhe do të përpiloj Strategjinë
- Personi përgjegjës duhet të ketë diplomë universitare në komunikim, zhvillim ndërkobëtar, menaxhim biznesi, marketing, apo fusha të ndërlidhura
- Referenca për përvojë pune në hartimin e strategjive në fjalë dhe mobilizimit të burimeve në sektorin e shoqërisë civile apo ate privat
- Aftësi të shkëlqyera analitike, lehtësuese, organizative, komunikuese, etj.
- Rrjedhshmëri të shkëlqyera në të folur dhe shkruar në gjuhën angleze

7. DOKUMENTET KRYESORE REFERUESE

Eksperti/Kompania konsulente do të ketë si referencë kryesore këto dokumente:

- Procedurat ekzistuese të ndërlidhura me ngritjen e fondeve dhe strategjive model
- Kodin e Etikës & Kodin e Sjelljes së Stafit të CK
- Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rriturve të Cënuar të CK
- CIMS – Caritas Internationalis Management Standards